



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK  
TIRANË


Rruga: “Aleksandër Moisiu”, Nr 80, Tiranë, Albania.  
Tel: +355 4374756, Fax 355 43 70058

Tiranë, 16/12/ 2009

BULETINI EPIDEMIOLOGJIK MBI QARKULLIMIN E GRIPIT TE RI  
PANDEMIK A(H1N1) NE SHQIPERI


Me poshte jepet nje pershkrim i gjendjes epidemiologjike dhe pasojave shendetesore lidhur me Gripin e ri pandemik A(H1N1) ne Shqiperi deri ne daten 16 Dhjetor 2009.

Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 25 - 49 të vitit 2008 dhe të vitit 2009. Numri i rasteve.  
(perkatesisht deri me dt. 6. 12. 2009).




- Ne grafikun e mesiperm duket qarte qe aktualisht kemi nje aktivitet te infeksioneve respiratore mjaft me te larte se nje vit me pare. Kete jave verejme perseri nje trend ne rritje te numrit te infeksioneve respiratore krahasuar me javen paraardhese. Ajo çka vihet re eshte se qe nga java 41-42 ( 12-19 Tetor) kemi nje rritje te menjehershme te infeksioneve respiratore e cila flet per qarkullim intesniv te nje virusi qe shkakton epidemi.
- Numri me i madh i rasteve te infeksioneve respiratore akute verehet ne moshat feminare.

**Krahasimi i aktivitetit të “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas sezoneve (javët 40 – 20) dhe Pragu Epidemik. Raste/100.000**




- Nga grafiku i mesiperm vihet re qe jemi ne nje periudhe te ngjashme me ate te gripit stinor por ky aktivitet kete vit eshte me i theksuar ne krahasim me te njeten periudhe te 10 viteve paraardhese. Kjo tregon perseri se kemi te bejme me qarkullimin intensiv te nje virusi te ndryshem nga ai stinor i viteve te meparshme. Ne kete rast flasim per virusin e gripit pandemik.
- Lidhur me gripin e ri A/H1N1, deri ne daten 16 Dhjetor 2009, jane marre 2357 mostra nga Tirana dhe rrethet. Numri me i madh i mostrave eshte marre ne grupmoshen 15 - 24 vjeç ku dhe vihet re dhe numri me i madh i rasteve te konfirmuara.
- Numri i pergjithshem i rasteve te konfirmuara me virusin A(H1N1) deri ne daten 16 Dhjetor 2009 eshte **334**. Moshë mesatare e rasteve te prekura ne total eshte 23 vjeç. Shumica dërrmuese e rasteve jane konfirmuar ne Tirane.
- Shenjat klinike te rasteve te konfirmuara gjate dy javeve te fundit kane qene mesatare. **Sot ne daten 16 Dhjetor eshte regjistruar rasti i peste i vdekjes prej Gripit te Ri Pandemik ne Spitalin Infektiv ne QSU, “Nene Tereza”, Tirane. Pacientja ishte nje grua shtatezane e moshes 18 vjeç e cila prej 6 ditesh ishte shtruar ne repartin e terapise intensive.**
- Survejanca ne te gjithe vendin eshte plotesuar me informacionin mbi shtrimet ne te gjitha spitalet e vendit si dhe eshte perforcuar survejanca per zbulimin dhe monitorimin e rasteve me semundje te rende respiratore.


### Shperndarja e rasteve te konfirmuara sipas javes se raportimit



### Shperndarja e rasteve te konfirmuara sipas grupmoshes



## Shperndarja e rasteve te konfirmuara sipas rretheve



**Frekuenca e hasjes së Infeksioneve Respiratore (të Sipërme dhe të Poshtëme) sipas rretheve në javën e 48-të dhe javën e 49-të të vitit 2009. Incidenca (raste/10.000)**

